

TJETËR*

2025

ÇUDË

01 / ÇUDË

A është e vërtetë se gjermanët hëngrën veç patate për 20 vjet?

“Gjermanët kanë hangër 20 vjet veç patate, qata janë zhvillu,” – shprehen pjesëtarë të popullit tonë (por jo vetëm) duke dashur të thonë sesa me rëndësi është me kursy për me mbërri diçka. Ose në raste tjera derisa e hanë ndonjë patate prej zori. Por, a është e vërtetë kjo gjë?

Po dhe jo!

Pse PO?

Siç mund ta dini, Gjermania e përshkruar nga ajo thënie sapo kishte dalë nga Lufta e Dytë Botërore. Shkatërrim ekonomik në të katër anët e saj. Varfëri e uri gjithandej. Ushqimi në atë kohë jepej me racione të vogla. E në ato racione, patatet (gjer. Kartoffel) ishin baba.

Duhet thënë edhe se në atë kohë Gjermania s’mund t’i përmbushte as nevojat ushqimore të saj, bile as me patate. Pra, dy nga dhjetë patate asaj i vinin nga jashtë.

Prej vitit 1945 e deri më 1948, një gjerman i moshës së rritur i hante nga 300 gramë patate në ditë. Por, këto patate nuk u hëngrën sepse gjermanët kursenin. U hëngrën sepse s’kishte çka tjetër të hanin.

Lexojeni këtë pjesë nga Nicholas Balabkins: “S’ka asnjë dyshim se dërgesat e ndihmave nga britanikët dhe amerikanët parandaluan vdekje masive nga uria në zonat e Gjermanisë që kontrolloheshin nga Perëndimi.”

E përkundër që i shpëtuan nga vdekja prej urisë, dhimbta nuk kishte qenë e vogël. Siç shkruan autori i lartpërmendur, patatet me drithërat përbënin 80 për qind të krejt asaj çka gjermanët hanin. Nga 3000 kalori në ditë sa duhej t’i merrte një njeri në ditë përmes ushqimit, gjermani i asaj kohe i merrte veç 1550 .

E mira është se Gjermania i kaloi ato kohëra të vështira. Por, jo duke ngrënë patate. I kaloi përmes investimeve të mëdha të Planit Marshall.

E megjithatë, lidhja me patatën do të mbeste. Në vitin 1960 çdo e dhjeta tokë e punueshme në Gjermani ishte mbjellë me patate. Prodhoeshin plot 33 milionë tonë patate në vit. Gjermania vazhdon të jetë mes top-10 prodhuesve dhe konsumuesve të patates në botë.

Pse JO?

Jo, sepse natyrisht rritja e konsumit përbën motorin e

zhvillimit të një shteti me ekonomi të tregut të lirë. Po të hanin gjermanët veç patate, atëherë i bie që do të dënonin të gjitha produktet tjera. Do t’i zhduknin krejt kulturat tjera bujqësore. Industria ushqimore do të ishte thjesht dhe vetëm industri e patates.

Gjermania dhe patatja

Mund të duket e çuditshme por për dyqind vjet me radhë prej shekullit XVI (kur erdhën prej Andeve në Amerikën Jugore) e deri në fund të shekullit XVIII, gjermanët e përdornin patatën veç për t’i ushqyer kafshët e tyre.

Pas një krize të rëndë me urinë në vitet 1770 monarkët gjermanë e kishin promovuar patatën si ushqim për t’u ngrënë nga njerëzit.

*Nicholas Balabkins, Germany Under Direct Controls

02 / ÇUDË

Çka e shtyu Kastriotin nga Mitrovica të bëhej i krishterë pas 13 vitesh ateist?

Quhet Kastriot. I ka 32 vjet dhe jeton në Mitrovicë. Duket si një kosovar i rëndomtë që e takojmë kahmos nëpër rrugët e qyteteve tona. Ama s’është bash i tillë.

Sapo i ndërron dy llafe me Kastriotin e kupton se ka diçka që nuk shkon. Menjëherë të lë përshtypje të fortë natyra e tij erudite. E pastaj mbetesh i hutuar me fjalët e tij që i qet prej goje me një farë sinqeriteti që ta pështjell krejt. Është prej të paktëve që përnjëmend e mendon atë që e thotë. Një cilësi kjo e njerëzve që diturinë e ndërtojnë me dije prej interesave të njëmendta.

Kurioziteti, leximet dhe fisnikëria karakteristike janë në kontrast të plotë me paperspektivën që e ofron Kosova. Me krejt banalitetet që na rrethojnë.

Për me ma pështjell edhe më zi, Kastrioti së fundi vendosi të konvertohej në të krishterë. Mu pështjell sepse ai ishte një ateist i vendosur. Një avokues pasionant i Darwinizmit dhe perspektivës evolucionuare thua se në cilindo debat.

Bisedova me të për me kuptu një këndvështrim autentik prej dikujt që jeton mes nesh.

1. Jetë e thjeshtë, lexime të pathjeshta

Fillimisht, e pyeta se çka e dallonte Mitrovicën prej qyteteve tjera të Kosovës përveç – ndoshta – pritjes së gjatë për me ble përcera.

“...Mitrovica është qytet i varfër dhe me mundësi shumë të vogla. Besoj se fakti që është qyteti me

numrin më të madh të njerëzve me asistencë sociale flet vetë,” – më tha.

Kastrioti jeton vetëm në një banesë me qira, të cilën e paguan me rrogën që merr nga puna në një portal lokal. Por, duket i kënaqur me atë që ka derisa shprehet se aktiviteti që e shijonte më së shumti, ishte edhe ai që e bënte më së shpeshti: leximi.

“Të ardhurat mujore momentale nga rroga më mjaftojnë për një jetë normale (së paku në standardet e mia të një jete normale) por që do të ishin të pamjaftueshme sikur të kisha familje. Dhe të krijoj familje është nga synimet kryesore.”

2. Krishterimi

Më pas, natyrisht, e pyeta në lidhje me konvertimin e tij në krishterim. Çka e bindi për ta bërë një gjë të tillë?

“Do të thoja këtë. Qe kur kam qenë i vogël jam tërhequr nga pyetjet filozofike e teologjike që lidhen me kuptimin e jetës. Kjo më ka shtyer të interesohem për fenë.” – ia nisi përgjigjes Kastrioti.

“Në fillim isha besimtar muhamedan. Ndër vite fillova të kaloj në dyshime të caktuara të cilat pak vite para se ta humbja besimin kulmuan në krizë të besimit fetar. Në moshën 20 vjeçare humba besimin. Isha ateist për gati 13 vite. Këto katër vitet e fundit fillova të ndjej zbrazëtinë e këtij botëkuptimi, ose më saktësisht botëkuptimit natyralist. Edhe për arsye se ka implikime serioze të frikshme mbi justifikimin e moralit. Pra, në këtë botëkuptim morali esencialisht është relativist dhe vetëm preferencë personale. Në këtë botëkuptim, morali në kuptimin e gjerë të fjalës duke qenë produkt i një procesi të verbër evolutiv do të mund të ishte krejt tjetër sikur evolucioni të kishte ndjekur kurs tjetër. Kjo nënkupton se gjykimi ynë, ta zëmë, mbi gjenocidin është thjesht aversion personal e nuk ka bazë objektive ku ti mund të thuash “gjenocidi është i pamoralshëm dhe pikë”. Pra në këtë botëkuptim gjykimi ynë për gjenocidin nuk dallon asgjë nga shijet e ndryshme për ushqimin. Kjo më kujton një shkëmbim në mes të biologut evolucionar të famshëm, Richard Dawkins, dhe Justin Brierley, për implikimet e evolucionit natyralist mbi të kuptuarit tonë të natyrës së moralit, kur ky i fundit e pyet nëse “ultimativisht besimi yt se përdhunimi seksual është gabim është po aq arbitrar sa fakti që kemi evoluuar pesë gishta e jo gjashtë”, dhe Dawkins ia kthen duke i thënë: “Mund të thuhet, po”!

Megjithatë, në fillim isha rezistent ndaj idesë së pranimit të besimit sepse nisesha nga parimi se e vërteta është ajo që ka rëndësi dhe zbrazëtia e botëkuptimit nuk është dëshmi automatike për Zotin e

për vërtetësinë e ndonjë feje. Por ndenja e peshës së zbrazëtisë se botëkuptimit ishte zhvillim domethënës sepse më shtyu të nis të hulumtoj. Më vonë erdha në përfundimin se në fakt natyralizmi në esencë e bën të menduarit tonë jo të mbështetshëm në të sepse evolucionit natyralist s’i intereson për të vërtetën dhe për të zhvilluar aftësi kognitive që na sigurojnë se mund ta penetrojmë realitetin objektiv por vetëm aftësi të dobishme të mjaftueshme sa për të mbijetuar. Kjo ka implikime serioze dhe për shkencën ngase shkenca bazohet në presupozimin metafizik se natyra funksionon sipas një rregulli e rendi, se sjellja e materies është e parashilueshme dhe që mendja njerëzore mund ta kuptojë këtë rend dhe rregull. Kjo e ka tmerruar dhe Darwinin i cili në një shkëmbim letrash me William Graham shprehet: “Por pastaj në mua, gjithmonë ngjallet dyshimi i frikshëm nëse mendimet e mendjes njerëzore, që është zhvilluar nga mendja e kafshëve më pak të zhvilluara, kanë ndonjë vlerë ose janë të besueshme fare. A do t’u besonte dikush mendimeve të mendjes së një majmuni, nëse ka ndonjë mendim në një mendje të tillë?”

Argumenti është më kompleks por kjo është forma bazike e tij.

Gjithashtu jam ndikuar nga filozofia aristoteliane-tomise sidomos në raport me argumentat për ekzistencën e Zotit. Ajo që është interesante është se shpie në përfundimin logjikisht të pashmangshëm se kjo Qenie është një. Gjatë kësaj kohe u binda se nëse ka ndonjë fe nga këto fetë monoteiste e cila mund të jetë e vërtetë, është vetëm Krishtërimi. Kështu, pas një kohe rrëmihje në filozofinë e fesë, teologji e histori të Krishtërimin me kohën rikuperova besimin në Zot e pak më vonë pas një reflektimi vendosa ta pranoj Krishtërimin.

Sa i përket reagimit nga të afërmit, jam fatlum që kam të afërm të cilët edhe pse mund të mos pajtohen me bindjet e mia kjo nuk reflektohet në raportet tona të shëndosha”.

E pyeta edhe në lidhje me Lëvizjen e Deçanit, e cila mori goxha shumë vëmendje mediatike vitin e fundit. I thashë se ma merrte mendja që ajo ishte ndoshta një farë reaksioni i çuditshëm e i përveçëm për shoqërinë tonë ndaj rritjes së ekstremit të djathtë nëpër Evropë ku islamofobia ishte e përhapur.

Qe çka më tha:

“Kam përshtypjen se po abuzohet me termin “Islamofobi”. Në Perëndim ka njerëz që janë të prirur t’i fusin të gjithë muhamedanët brenda një vlerësimi negativ dhe kjo është e gabuar. Por shumë nga ajo që konsiderohet Islamofobi në të vërtetë është reaksion

ndaj doktrinës Islamiste, komponenta më problematike e të cilës është ajo teokratike. Njerëzve thjesht u ka ardhur në maje të hundës arroganca urrejtëse ku u thuhet se bota e krishterë do t'i nënshtrohet Muhamedanizmit e se shteti duhet të qeveriset me shariat. Për më tepër, kjo paraqet vazhdimësi të qasjes armiqësore që ka nisur nga koha e ngjizjes së vetë Muhamedanizmit, kur pasuesit e themeluesit të tij relacionin me botën e krishterë e nisën me gllabërime me luftë të territoreve të botës së krishterë e me nënshttrim të popujve të saj. E di që historia nuk duhet të kuptohet në terma bardh e zi dhe jam i vetëdijshëm se bota arabe ato kohë ka dhënë kontribut të çmuar në shkencë e filozofi. Por qasja ndaj botës së krishterë që nga fillimi ka qenë armiqësore. Kjo qasje është vazhduar pastaj dhe nga Perandoria Otomane. Gjithsesi jo të gjithë muhamedanët janë Islamistë.

Sa i përket Lëvizjes së Deçanit, më brengos motivi i tyre për t'u konvertuar. Në besimin e krishterë motivi i vetëm për konvertim duhet të jetë besimi se Krishti është e Vërteta dhe ky motiv s'guxon të kontaminohet nga konsiderata të tjera. Kam dëgjuar se madje ka nga ata që konvertohen të cilët në fakt s'besojnë por e bëjnë për arsye nacionaliste. Kjo është e papranueshme: është sakrilegj në radhë të parë e pastaj dhe ofendim, patronizim e instrumentalizim i besimit të krishterë. Duhet të kenë më shumë respekt ndaj kësaj feje”.

03 / ÇUDË

Për tre minuta – në një ditë shkurti mes orës 10:45 dhe 10:48 – edhe Zoti ‘u tall’ me Kosovën

Ndaras prej njëri-tjetrit, thujse në të njëjtin kohë (fundi i shekullit 17), Gottfried Leibnizi dhe Isaac Newtoni e zbuluan kalkulusin. Ndaras prej njëri-tjetrit, thujse në të njëjtën kohë (sot, njëri në orën 10:45 e tjetri në orën 10:48) Çun Lajçi me Rexhep Qosja e na e zbuluan një tallje hyjnore me vendin tonë.

Ora 10:45

Çun Lajçi – një aktor e shkrimtar me nam për kushtet tona – shkroi në Facebook për një personazh të një ‘reality show’. Ishte një glorifikim i përmasave të pabesueshme. Një varg lëvdatash që ngjanin me ato që i bëjmë për heronjtë më të mëdhenj.

“Ta dua guximin, energjinë, elanin, dëshirën për të bukurën, për të paarritshmen, për jetën përtej mureve, tej grilave; dëshirën për ta vënë në sprovë vetveten dhe për t'u ballafaquar me një forcë që tejkalon

tënden!” – thoshte Lajçi në postimin e tij që deri në këtë moment (ora 12:37) i numëron mbi dy mijë pëlqime.

Nga fjalët tjera të këtij postimi kuptojmë se Lajçi – aktor 78 vjeçar – është një shikues pasionant i këtij ‘reality show’.

Ora 10:48

Rexhep Qosja – një shkrimtar dhe publicist me nam për kushtet tona – shkroi po në Facebook një akuzë të rëndë ndaj sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës.

“Ata e kanë formuar një kartel (një DIKTATURË GJYQËSORE) dhe po mbrojnë korrupsionin sistemik që i solli në postet e tyre.” – tha ai. Nuk dha asnjë provë, asnjë argument. Të paktën, ndonjë që mëson të rinjtë sa për t'i mësuar të rinjtë të komunikojnë më me kulturë me njëri-tjetrin. Që i mëson të mos bëjnë thashetheme. Të mos akuzohen pa prova. Që kur tjetri të thotë diçka për dikë, ti ta pyesësh: po bre, ama ku janë provat e argumentet?!

E për më keq, akademiku 89 vjeçar e kishte bërë edhe një fotomontazhë – si duket me Inteligjencë Artificiale – ku dukeshin disa gjyqtarë, çekani i drejtësisë, do grila, dhe disa njerëz të maskuar. Ishte dramatike. Ishte e frikshme. Ishte e errët.

Pavarësisht se çka mendojmë për sistemin tonë të drejtësisë, besoj pajtohem të gjithë se është e padrejtë të hedhim akuza të pabaza e të bëjmë fotomontazha të errëta e të frikshme me Inteligjencë Artificiale?

Çka na thotë kjo?

Marrë parasysh që këto postime i kanë ndërmjet veç tre minuta, mundet me qenë një tallje hyjnore me shoqërinë tonë. Një tallje që thotë: “Ja, këta ishin në krye të gjeneratës që e ndërtoi Kosovën. A mendon ende se ia vlen me jetu këtu?”

04 / ÇUDË

Fjalimi i Unikkatilit që i zhgënjeu keq fansat e tij

Poshtë e përpjetë nëpër Facebook po pëshpëritej të enjten për fjalimin e një reperi në varrimin e vëllait të tij. Ishin pëshpërima që e shprehnin si me marre një zhgënjim të thellë.

Ishte fjalimi i Unikkatilit, një reperi shqiptar që jeton në Amerikë. Reper që është dëgju me të madhe nga një pjesë e madhe e rinisë dhe ish-rinisë në Kosovë.

Zhgënjimi – që më vonë kaloi edhe në tallje – kishte të bënte me përmbajtjen e atij fjalimi. Ishte i cekët.

Ishte i sikletshëm. Ishte për marre. E më the e të thashë.

“Na ka shti n’dyshime me qët fjalim a i ka shkru vet qato tekste të kongve?!” – ishte komenti i njërit. “Çudi qysh ka ditë me i lexu tekstet ky, se me i shënu vet po dihet që jo.” – tha një tjetër.

Fjalimi

E dëgjova atë fjalim për me kuptu çka ishte puna. Po, fjalimi ishte tepër i dobët. Marrë parasysh që fjalimi në varrimet e krishtera është një institucion me shumë rëndësi, ai fjalim ishte... bërlllok e gjysmë.

Unikkatili e ndau një kujtim për vëllanë, por të thënë aq keq sa...

“Ka shumë gjana që kisha mujtë me thon, ton ditën me ju majtë ktu. Po po nisna prej senit që kur jena kon n’vogjëli, përshemëll, Mentori u kon nifar sherri. Edhe une jom kon sherr po pak ma i vogël se ai... edhe tash, bojke sherre kështu ma shpesh... edhe u kon ni moment nihere qi une pata bo diçka... e baba jem na ndëshkojke nifar mënyre... edhe pse nuk u kon i dhunshëm... edhe, ka pasë ndodh nihere ni rast kur e pata bo une ni sherr edhe Mentori ma i vogël se une edhe baba e fajësoj ata. Edhe e maj men, ai e hongër ndëshkimin edhe me q* nonën nuk kallxoj që une e kom bo. Qaj u kon vllai jem.”

Siklet!

E më vonë, në nderim të kujtimit për të vëllanë e vdekur ai e quan edhe “p*dh some”.

Nejse. Puna është se ky fjalim s’ishte më ndryshe se tekstet e tij. Ishte po aq i dobët ose po aq i fortë sa të gjitha tekstet tjera.

Muzika

Dëgjojeni këngën e fundit të publikuar në kanalën e tij në YouTube . Quhet “Rêja”. Është larg më e sikletshme se meselja në varrim. Me një sens të pabesueshëm megalomanie ai tregon për ngjarje krejt të kota të fëmijërisë. “...u rroka me do ujë t’nxeh të valë, e mandej u përvlova”.

Më pas, kënga vazhdon me “oj nanë”; “oj nanë”; “oj nanë”. Unikkatili e paraqet një diskutim me nënën e tij, dhe tregon se po e ndjek një farë reje. Pra, e ka një farë mallkimi – me të cilin fryhet për ata që e kuptojnë – që e shtyn ta bëjë atë gjë që s’duhet.

Për dikë është aq e kotë sa s’do ta marrë veten për kohë të gjatë. E dikujt me gjasë edhe i ka pëlqyer. 1.7 milionë shikime.

Nëse dëgjoni këngët tjera, do ta kuptoni që në një anë kemi një imoralist që promovon dhunë kah të sillet

(kështu e ka repi?) e një tjetër një moralist që viktimizohet sa mundet. (kështu s’e ka repi?) Në odën e mendjes së tij, vetja është në krye të vendit. Një narcisizëm i zakonshëm në botën e vogël të këtij zhanri. Më andej, nana – diçka e çuditshme. Më poshtë kombi e feja. Diku më në mes një mixhë. E kështu me radhë.

Na rastisi ta dëgjonim për 7 mars – Epopeja e UÇK-së – një reper që quhej Gold AG. Kishte odë gati identike mendore si Unikkatili. Veç ndoshta meselet në varrime i ka më të mira?!

Pse një fjalim në varrim shërbeu si ekspozim i nivelit të reperit për kaq shumë njerëz? Ndoshta se... në imagjinatën e tyre reperi në botën reale fliste më bukur e më mirë se në atë virtuale? Njësoj sikur fansat e Mr. Bean të zhgënjeheshin sikur aktori edhe në jetën reale të sillej sikur Mr. Bean?!

05 / ÇUDË

Hyra me këqyr qysh poshtërohen qebapat, dola me traumë nga budallallëku

Para disa ditësh, një kronikë nga Klan Kosova u vë virale gjithandej.

Kronika thoshte se një modele po hante qebapa përkundër që vetura i kushtonte 270 mijë euro. Në anën tjetër, viraliteti i kronikës e shkarraviti atë tregim dhe tha diçka tjetër: s’ka lidhje që modelja hante qebapa – të gjithë hamë; Klan Kosova televizion i poshtër; gazetarët të padijshëm; modelja e pafajshme, qebapat e pafajshëm etj.

Bota e Klan Kosovës u ndesh me botën e Kosovës. Por, çka nëse s’ishte ashtu siç dukej?

Fëlliqtë

Kur e pashë atë kronikë, u rrëqetha. Uhhh. Fëlliqtë! Gërditshëm! Më humbte dinjiteti si shikues derisa sekondat vazhdonin. Por, prit... pse kjo kronikë ishte më e punuar se kronikat politike?

Teknika e të rrëfyerit ishte ajo e një mokumentari . Pra, rrëfimtaria (narratorja) supozohej të parodizonte me kronikat e këtij lloji. Me storiet e këtij lloji. S’ishte kronikë por tallje e kronikës. I gjithë budallallëku ishte i inskenuar. Problemi ishte i karikaturuar.

Apo, jo?

Atëherë pse s’prezantohej si tallje që në fillim? Pse po prezantohej si diçka e vërtetë? Duket se, s’ishte veç qebapi që e pësoi prej saj.

Siklet

Të zhytemi thellë në siklet. Të bëhemi ibret mirë.

Gazetarja në fjalë nuk tregon pse qëlloi i shkoi pas modeles bash atë ditë. Pse vendosi ta priste? Çka nëse ajo rrinte në kafene për orë të tëra? Çka nëse kthehej mbrapsht në banesë?

“Pas nja gjysmë ore pritje në kompleksin ku banon, doli (modelja) prej kafenesë poshtë banesës.” – shprehet gazetarja që s’tregon pse ishte ajo vetë aty.

Me një ton serioz, ajo më pas fillon – disi denoncueshëm e lavdërueshëm – të prezantojë rrobat e shtrenjta të modeles, çantën 20 mijë euro, veturën 270 mijë euro. Pse? As këtu s’ka përgjigje.

Më pas, gazetarja me ekip të saj fillon me ndjekë modelen që po shëtitej me veturën 270 mijë euro. Pse? S’ka përgjigje.

Pasi tregon që ajo po jepte shenjë në çdo kthesë, e që shëri i veturës së ‘madhe e të mirë’ e kishte zor parkingun, inskenohet edhe konflikti.

Shikimi i modeles qartazi tregon se ajo po e priste gazetaren. Në anën tjetër, shoqëruesja e saj as që e kthen kryet për ta parë (2:56-2:59) sepse e dinte që do të vinte.

Konfrontimi është po ashtu i inskenuar. Modelja bëhet sikur po irritohet me shkeljen e privatësisë, megjithëse... qeshet vazhdimisht dhe përgjigjet në pyetje.

Qebapi është fyer? Jo, zonja dhe zotërinj. Këtu kemi dallavere të rënda, s’është punë qebapi a standardi. Kemi një poshtërim të gazetarit dhe mashtrim të qytetarëve.

Modelja e viktimizuar provoi të përfitonte nga situata. Paralajmëroi padi. Dilte me qebapa nëpër storie . I mori me një emision . Provoi të përfitonte edhe Klan Kosova që bëri storie tjera për atë temë pavarësisht që s’kishte temë.

Qysh me shpëtu?

Fjala e lirë duhet të ruhet me çdo kusht. Por, fjala e korruptuar s’është e lirë. Fjala e paguar, e porositur s’është e lirë. Siç është as ajo që synim të vetëm ka provokimin e reagimeve. Edhe kjo duhet mbrojtur që të shprehet. Por, jo edhe nga pasojat ligjore e morale.

Dorën në zemër, s’ka lidhje nëse dikush të gjykon pse han qebapa. Fundja, këtë gjykim mund ta bëj edhe një vegjetarian. Dhe, bota është kjo që është. Njerëzit kanë dieta të ndryshme ushqimore. E më the e të thashë.

Problemi i kësaj kronike s’është argumenti që shtron. Problemi është që s’ka argument hiç. Ka veç provokim.

06 / ÇUDË

Kurti në fakt i mashtroi rusët: Bëhej sikur iu besonte që ishin Presidenti i Letonisë* (Prova)

E keni të zorshme me e gjetë një gjykim jotendencioz mbi mashtrimin që i ndodhi kryeministrit Albin Kurti nga dy hajgarexhitë rus (pa ‘ë’). Qe ku e keni një. Kurti në fakt i mashtroi rusët për t’i bërë të besonin se po iu besonte që ata ishin presidenti i Letonisë. Provat i keni më poshtë.

Askush s’e mohon që s’është gjë e mirë që kryeministri u mashtrua. Dy rusët që u prezantuan si presidenti i Letonisë – Vovan dhe Lexus – mund të jenë pjesë e inteligjencës famëkeqe ruse dhe kjo e rrezikon sigurinë tonë kombëtare. U duk keq në sytë e botës. Në sytë e militantëve. Në syzet e neve që s’shohim aq mirë?! Por... ka një dredhim këtu.

#prova I

Kurti u fut në një listë të begatshme me figura të mëdha anti-Putin në kohën kur orvatjet e tij për ta dëmtuar invazionin rus në Ukrainë po dukeshin sikur nuk po jepnin efekt të madh.

Në këtë listë të njerëzve të mashtruar ku bën pjesë tash edhe Kurti është presidenti Bush, zv. Presidentja Kamala Harris, sekretarja Hillary Clinton, Thomas Bachu i Komitetit Olimpik, Angela Merkeli, Mike Pompeo, David Cameron, Kaja Kallas, Pedro Sanchez etj.

Futja në këtë listë të bereqetshme me emra të mëdhenj e bën Kurtin një tjetër anti-putinist të madh. Dhe i jep zë më shumë në këtë rreth global anti-autokratik?!

Për më tepër, një militant i përbetuar mund të thotë që është nder të jesh mes këtyre emrave. Ndoshta, edhe një i papërbetuar?

Kjo kallëzon – më e pakta – që edhe lufta e Kurtit ndaj Putinit po vërehet. Dhe se s’është aq huqje e madhe meqë iu ndodhi edhe të lartpërmendurve.

Rri me ne. Provat tjera janë edhe më të forta.

prova II

Kurti s’u paraqit si homofob gjatë atij rrengu. Mos e dëgjoni Halil Matoshin se ngutet. S’po i thoshte rusëve “Grenelli është vetë gej” në kuptimin negativ të fjalës por në kuptimin pozitiv të fjalës. Pra, Grenelli e

ka një cilësor të mirë (është gej) por po i del kundër komunitetit të tij.

Por, zonja dhe zotërinj që besoni te barazia mes sekseve e te liria seksuale. Por. Por. Por. Dhe vetëm POR.

Albin Kurti ynë i dashur – lideri më progresiv që tash edhe po e mbështet haptas Kodin Civil – del se është goxha i padijshëm për këto punë. Të mos e dijë Kurti se çka janë drag show -t? Pasha një allah dhemb.

“Besoj që Trumpi e vendosi (Grenellin) në pozitën kundër dragëve? Ose kështu diçka? Kundër LGBTIQ? Edhe pse ai është vetë gay.” – tha Kurti duke i shfaqë pasiguritë e tij.

Kurti i mbushi 50 vjet në bythë më 24 mars. E mos ta dijë çka janë dragët? S'ka shansë.

Zoti na ruajtë!

Albini ynë fatkeqësisht paraqitej që s'e dinte as çka ishte Kennedy Center. Mos ndoshta rusët kanë rënë në rrengun e tyre. Ata janë mashtrur që folën me Albin Kurtin?

prova III

Albin Kurti t'i ngatërrojë talibanët me muxhahedinët?!

“Talibanët furnizoheshin me aq shumë armë derisa e dëbuan Bashkimin Sovietik.”

Zor të besohet kjo. Shumë zor të besohet kjo të nderuar lexues.

Por, ka edhe më zi. Kurti i përngjau Zafir Berishës kur shumësin e talibanëve në anglisht e bëri “ talibans ”. Kjo është e ngjashme me gabimet e Zafirrit. Ta zëmë, kur ai e shkruan “ parasyshË ”. Ose “ puplikishtË ”.

Albin, vëllaçko, a je ti? Po, Albin Kurti ishte. Por, po bëhej sikur po iu besonte rusëve.

Ose, mos nuk ishte ky Albin Kurti fare? Mos u përdor ndonjë sozi e tij për t'i mashtruar rusët?!

Tjetër?

Po, ne jemi Tjetër – magazinë online që funksionon në baza vullnetare. Na mbështet! Përpos teksteve të tilla sarkastike, kemi edhe plot e përplot materiale serioze. Falemnderit!

@tjetermagazine Kurti u mashtrua keq nga dy hajgarexhi rus që u prezantuan si Presidenti i Letonisë #kosova #fyp #albinkurti #kryeministri #prankvideo #hajgare #tjetermagazine 🎵 original sound – tjetermagazine

07 / ÇUDE

Kush është në të vërtetë qeni endacak që u bë viral këto ditë?

Rrëfimi për qenin që priste para semaforit s'është aq i thjeshtë. Më besoni që s'është.

Është bërë tashmë virale një video që tregon sesi një qen në Prishtinë priste baraz me këmbësorë në semafor, dhe u nis veç kur u ndez e gjelbra.

E keni gjithandej.

GazetaExpress tha : “ Qeni në Prishtinë pret dritën jeshile në semafor për të ecur, respekton rregullat ”

Ballkani.info tha : “ Qeni në Prishtinë pret dritën jeshile në semafor për të ecur, respekton rregullat ”

Insajderi tha : “ Qeni në Prishtinë pret dritën jeshile në semafor për të ecur, respekton rregullat ”

PrishtinaPress tha : “ Qeni në Prishtinë pret dritën jeshile në semafor për të ecur, respekton rregullat ”

A po vëreni diçka? Ia kanë vjedhë njëra-tjetrës lajmin këto portale? Po, po por s'është këtu problemi.

Këtu ajo që lë përshtypje është mënyra sesi i referohen qenit në fjalë. Ky është qen endacak, por kësaj here meqë po bën diçka të mirë po i referohen thjesht si qen . Po të bënte diçka të keqe, do t'i referoheshin me mbiemrin endacak .

Si lojtarët nga Kosova që luajnë për Shqipërinë: kur luajnë mirë janë shqiptarë krenarë, por kur luajnë keq janë kosovarë!

Kush është qeni i semaforit?

Bre ku e kishim parë këtë qen?! Ah, po. Ishte i njëjti qen që e kishte pritur semaforin edhe në vitin 2023 . Insajderi na informonte atëbotë për këtë veprim të mençur (Pra, i bie që lajmi e Expressit e të tjerë as që ishin të vërtetë. Ajo pritje kishte ndodhë më herët).

Por, ai s'është i vetmi. Qeni në fjalë është mes një numri të madh qensh që kanë pritur të gjelbrën nëpër semaforë të ndryshëm ndër vite.

S'më besoni? Qe një qen tjetër që pret në semafor. Qe një tjetër . Lypni në Google dhe do të shihni plot qen që presin semaforin.

Dhe, askujt s'i referohen njerëzit pas tastierave si qen “ endacakë ” meqë ky mbiemër tashmë është bërë tepër pezhorativ.

Një gazetar nga Danimarka që jeton/te në Kosovë, Jakob Weizman, ka bërë para disa javësh një shkrim në të cilin denoncon qasjen diskriminuese të mediave, qytetarëve e komunës ndaj qenve endacakë.

Shkrimin e tij mund ta lexoni KËTU .

Për fund, kemi një pyetje për ju: mos po hyjmë në gjynah duke i bërë qentë nga viktimat në agresorë? Historia që nuk mësohet, përsëritet. Ne kosovarët e dimë më së miri këtë gjë.

08 / ÇUDË

I dashuri im është militant i Lutfi Hazirit – a duhet të ndahem prej tij?

Pyetja

Të dashurin e kam të mençur e me sens humorit. S'mërizem kurrë kur flas me të. Më bën me qeshë derisa s'ngihna frymë. Seksi është fantazi. Jemi bashkudhëtarë të mirë.

Problemi është se ai është me Lutfi Hazirin. E di që Luta është njeri i poshtër në çdo formë të mundshme. E përçmoj si person dhe ia përçmoj qëndrimet me çdo fibër të qenies time. I dashuri s'i ngrit dy gishta, s'ka vathë në cicë dhe e pranon se Luta i ka disa mangësi, por thotë se "ia pëlqen politikat" dhe planifikon me votu edhe në të ardhmen... përsëri. E kam pyet se a mundet diçka me zhgënjy prej Lutës, por s'i bjen ndërmend kurrëgjë hijë.

Natyrisht, provojmë mos me folë për politikë, por të dy i përcjellim zhvillimet e fundit nga afër, dhe çdo muaj përfundojmë në grindje dhe veç kur e gjej veten duke e vënë në pikëpyetje lidhjen me të.

A mos po tregohem e pasinqertë me bindjet e mia morale duke qëndru në një lidhje me dikë që e mbështet një person që unë e konsideroj të gërditshëm?

Përgjigja

E dashur lexuese,

Kollaj e ke.

Shijoje Lutën tënd! Përqaftë; çmoje; kallëzoji qysh bëhet kjo punë. Përtheqoje me krahë krejt lutfillëkun e tij, përreth krejt therjeve të vathëve të tij, dhe këqyre qysh shkrihet në dallgët e një gjëneroziteti hyjnor.

Njerëzit që duam: gjithmonë ka diçka që s'shkon me ta, sepse gjithmonë ka diçka që s'shkon me krejt neve. Ai mund të kishte higjienë të dobët, apo probleme me drogë, apo farë hobi katastrofë. Mundet me qenë pjesë e chateve të gërditshme. Mundet me pasë opinion deluzional për veten.

Sa më shumë që plakem, aq më shumë besoj se opinionet personale të një personi – qoftë politike,

qoftë çfarëdo – janë gjëja më e parëndësishme për ta. Qysh jetojnë, qysh iu bëjnë me u ndi – kjo ka vlerë.

Lutfillëkun, në formën më të pastër, besoj se është si erë e zezë që vjen nga thellësia e kaosit. Por, normal ka shkallë të ndryshme të Lutfillëkut. Dhe, a s'e keni çu ndërmend ndonjëherë se lutfillëku i tij, dhe mos-lutfillëku yt, mund të jetë sosi sekret i lidhjes tuaj? Çelësi për sensin e tij të humorit, shkëndija erotike, ajo që e bën interesant për ty? Dhe jeni bashkudhëtarë të mirë, hej! Siç ka thënë Walker Pery, nëse një burrë e një grua mund të rrinë bashkë me një kerr për 321 kilometra (pak më larg se prej Prishtinës në Durrës), atëherë duhet me u martu menjëherë".

Ekziston gjithmonë ky paradoks për personin që do: s'mund t'i merrni për të mirëqenë, e megjithatë i merrni si të mirëqenë. Duhet ta kujtoni atë që i bën të rrallë, ndjesinë unike që ta japin dhe brishtësinë e krejt asaj.

Mendimi i fundit: Nëse s'do të grindeshit për Lutën, do të grindeshit për para. Apo për besimin në Zot. Apo për qysh me lëshu maçinën e enëve. E sa për Lutën: mos e lini që ta shkatërrojë një tjetër gjë të bukur.

Rrëfimi dhe këshillimi është autentik dhe është botuar në The Atlantic . Në vend të "partnerit" e kemi përdorur "i dashuri" edhe pse e dimë që s'kanë të njëjtin kuptim. Dhe, në vend të Lutfi Hazirit ishte fjala për Donald Trumpin në shkrimin origjinal. E bëmë Lutfi Hazirin e jo Albin Kurti, sepse s'dëshëm të sulmoheshim prej militantëve të këtij të fundit. Fundja, jemi magazinë online që funksionon pa asnjë cent. 😊

09 / ÇUDË

Qe sa lehtë i bën për vete shqiptarët Putini

Kur zakonisht flitet për influencën ruse në Kosovë, mendohen dezinformatat në gjuhën serbe kryesisht për komunitetin serb në Kosovë. Jo edhe shqiptarët e Kosovës. Nuk mendohet gati asnjëherë se si mund të preket ndonjë nerv konservator në shoqërinë tonë. Eh, ja që e gjetëm sa lehtë mund t'i bëjë për vete shqiptarët edhe një despot si presidenti rus Vladimir Putin.

Videoja e mëposhtme do t'iu tregojë se deri në çfarë mase janë në gjendje të shprehin pajtimin e tyre haptas e publikisht shqiptarët me një lider kriminal. Vetëm e vetëm që ai 'guxoi' t'i ndalonte martesat mes personave të seksit të njëjtë.

Ishte goxha e rëndë për ta parë për ne. E besojmë se do të jetë edhe për ju.

10 / ÇUDË

Profili i rrejshëm super-popullor që përçan politikisht Kosovën duke dëgju muzikë serbe

Profilet e rrejshme po bëjnë kërdi në seksionin e komenteve në rrjete sociale. Por, ka një zhvillim edhe më shqetësues. Disa prej këtyre profileve të rrejshme janë bërë super-yje në debatin publik në Kosovë.

I tillë është profili i Jona Çitakut, që i ka 20 mijë ndjekës. Duke u prezantuar rrejshëm si person i vërtetë, ky profil provon të deformojë mënyrën se si njerëzit mendojnë e gjykojnë për zhvillime politike.

Përgjatë dy javëve të fundit, ky profil i rrejshëm i bëri 101 postime. Nga ato postime, i mori 115 mijë reaksione ose mesatarisht nga 1115 për një postim. Po ashtu, gjeneroi edhe nja 13 mijë komente dhe... 6729 shpërndarje. Sa prej jush keni kesi profili të fuqishëm, edhe pse jeni njerëz të vërtetë?

Postimet e bëra prej këtij profili të rrejshëm shpërndajnë gjuhë të urrejtjes ndaj opozitës dhe mbështetje për Albin Kurtin.

Në këtë postim e dehumanizon Lumir Abdixhikun dhe e quan “klysh”. Në këtë postim e quan “njeriun më të gërditshëm në Kosovë”. Në këtë tjetrin, bën thirrje që LDK të zhduket. Këtu shpërndan urrejtje ndaj Hykmete Bajramit.

Pra, pambarimisht i sulmon mediat, gjyqësorin e madje edhe votuesit e partive opozitare. Vetëm sa për t'i nxitur më shumë mbështetësit e Kurtit.

Këtij profili të rrejshëm me kaq shumë aktivitet politik ia shpërndan postimet edhe hiç më pak se Elvis Hoxha, një prej aktivistëve më të respektuar në Vetëvendosje. Por, ia shpërndan edhe Hysamedin Feraj. Të dy kanë punuar si këshilltarë të kryeministrit. Merreni me mend.

Por, kush qëndron prapa këtij profili të rrejshëm? Është e pamundur të dihet. Nga të dhënat e Facebook-ut, kuptohet se profili i rremë është hapur më 24 mars 2020. Dhe se ndjek disa figura publike shqiptare, si Labinot Tahiri e Grida Duma. Dhe e çuditshmja është se e ndjek edhe... një këngëtare serbe me emrin Katerina Grujiq. Kjo është veçanërisht e çuditshme, marrë parasysh që profili promovon gjithë kohën nacionalizmin shqiptar.

Prandaj, po e shihni se profilet e rrejshme si ky jo vetëm që na e rrezikojnë lirinë dhe demokracinë tonë, por mund ta rrezikojnë edhe sigurinë kombëtare. Duke parë se sa të pavëmendshëm jemi, vendet armike të

Kosovës mund të investojnë në kesi profilesh që t'i rrisin përçarjet mes nesh.

Prandaj, hapi sytë. Mos lejo që profilet e rrejshme – pavarësisht cilën parti bëhen sikur e mbështesin – ta vjedhin zërin e qytetarëve të vërtetë.

Kjo këtu është pshurrje e demokracisë. Kur dikush mashtron kaq hapur dhe merr mbështetje kaq hapur ani pse mashtron... kjo është mohim i sakrificave të mëdha të kombit tonë për të drejta dhe liri politike.

Për fund, mos harro ta bësh Subscribe kanalin tonë në YouTube. Ne jemi një kanal i ri dhe i vogël në nevojë të mbështetjes për ta mbrojtur sferën publike të vendit tonë. Bëhu vigjilent!